



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 443**  
**Lënda: Cilësia e shërbimit shëndetësor**

| PROGRAMI I LËNDËS<br>Cilësia e shërbimit shëndetësor |      |   |         |     |          |                |                   |        |
|--|------|---|---------|-----|----------|----------------|-------------------|--------|
| Titullari / pedagogu i lëndës:                       |      | Yllka Stramarko <i>Profesor Doktor</i> _____  |         |     |          |                |                   |        |
| Ngarkesa:  | ECTS | Orë mësimi në auditor   |         |     |          |                | Studim individual | Totali |
|  |      | Leksion   | Seminar | Lab | Praktikë | Projekt klinik |                   |        |
|  | 5    | 30  | 15      | 0   | 5        | 5              | 70                | 125    |
| Tipologjia e lëndës                                  |      | Lëndë disiplinore / integruese  |         |     |          |                |                   |        |
| Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda         |      | Viti I, Semestri I  |         |     |          |                |                   |        |
| Lloji i lëndës                                       |      | Lëndë me zgjedhje   |         |     |          |                |                   |        |
| Programi i studimit                                  |      | Master Profesional në Infermieri Pediatrike   |         |     |          |                |                   |        |
| Kodi i lëndës  |      | INF 443   |         |     |          |                |                   |        |
| Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës |      | <a href="mailto:Yllka.bilushi@univlora.edu.al">Yllka.bilushi@univlora.edu.al</a> , <a href="mailto:yllkabilushi@hotmail.com">yllkabilushi@hotmail.com</a> |         |     |          |                |                   |        |

| PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT |   |
|--|---|
| <b>Përmbledhja</b>                     | Ky modul e pajis studentin me kapacitetet e nevojshme për vendosjen e pacientit në qendër të shërbimit infermieror, nëpërmjet një komunikimi dhe qëndrimi etik të personalizuar, si dhe rritjes së standarteve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit infermieror.   |
| <b>Objektivat e lëndës</b>             | <ul style="list-style-type: none"><li>Njohja me problemet etike të situatave jo të zakonshme të praktikës mjekësore.</li><li>Vlerësimi i performancës në kujdesin shëndetësor.</li><li>Njohja me procesin e akreditimit të institucioneve shëndetësore dhe standartet e sigurisë.</li><li>Vlerësimi i mjeteve bazë të cilësisë dhe përdorimit në projekte të vogla.</li></ul>   |
| <b>Rezultatet e të nxënit</b>          | Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>Të ketë përvetsuar teknikat e komunikimit me kategoritë më problematike të pacientëve.</li><li>Të njohë standartet etike të komunikimit dhe vendim-marrjes.</li><li>Të vlerësojë dhe monitorojë standartet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit shëndetësor.</li><li>Të përdorë mjetet bazë të cilësisë në projekte klinike të vogla.</li></ul> |

| KONCEPTET THEMELORE |  |
|---------------------|--|
| 1.                  | Problemet etike të situatave jo të zakonshme të praktikës mjekësore. |
| 2.                  | Standartet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit infermieror.         |
| 3.                  | Procesi i akreditimit të institucioneve shëndetësore.                |
| 4.                  | Standartet etke të komunikimit dhe vendimmarrjes.                    |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|------|----------------|----------------------|----------------------|
|------|----------------|----------------------|----------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

| Java | TEMAT E LËNDËS   | Literatura referuese   | Forma e mësimdhënies   |
|------|--|--|--|
| I.   | <p><b>Tema 1</b>-Njohuri të përgjithshme për etikën dhe deontologjinë mjekësore. Bioetika, disiplinë e re.<br/><i>Etika Mjekësore (EM) studion normat e sjelljes, parimet morale të punonjësve të shëndetësisë në veprimet e tyre profesionale.</i></p> <p><b>Tema 2</b>- Etika dhe morali. Teorite rreth etikes.<br/><i>Njohja me moralin, si një qëllim që pasqyron veprimet e njerëzve. Si i klasifikojmë teoritë e etikës sipas burimit, prejardhjes dhe rrënjëve të moralit.</i></p> <p><b>Seminar 1</b>: Cfarë studiojnë etika, bioetika dhe deontologjia mjekësore. Përkufizimi i moralit dhe teoritë e etikës.</p> | <p><sup>(1)</sup>fq.1 –6</p> <p><sup>(1)</sup>fq.6 -9</p>      | <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> |
| II.  | <p><b>Tema 3</b>-Pacientët, grupet e kujdesjeve mjekësore dhe shoqëria e hapur.<br/><i>Njohja me etikën me pacientin dhe konsentin e tij për mjekim. Të drejtat kryesore të pacientit. (Fq 9-16)</i></p> <p><b>Tema 4</b>-Pamje etike-juridike në lidhje me të fshehtënjën mjekësore.<br/><i>Njohja me kuptimin etik dhe juridik mbi sekretin mjekësor. Sekretin mjekësor ndaj pacientit. (Fq 17-22)</i></p> <p><b>Seminar 2</b> koncepti i saktë i sekretit mjekësor dhe të drejtat e pacientit.</p>  | <p><sup>(1)</sup>fq.9 –16</p> <p><sup>(1)</sup>fq.17 -22</p>   | <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> |
| III. | <p><b>Tema 5</b>-Problemet etike-juridike të shkeljeve mjekësore.<br/><i>Kuptimi etik dhe ligjor i gabimeve mjekësore dhe klasifikimi i tyre. Kodi deontologjik dhe penal kundër shkeljeve mjekësore.</i></p> <p><b>Tema 6</b>-Problemet etiko-juridike të situatave jo të zakonshme të praktikës mjekësore.<br/><i>Njohja me konceptin e refuzimit terapeutik, të teprimit terapeutik, të mjekimit paliativ dhe gjendjes vegjetative.</i></p> <p><b>Seminar 3</b>: Të diferencojmë saktë konceptet e gabimeve mjekësore, të tepromit dhe refuzimit terapeutik si dhe mjekimin paliativ.</p>                               | <p><sup>(1)</sup>fq.23 –29</p> <p><sup>(1)</sup>fq.30 -35</p>  | <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> |
| IV.  | <p><b>Tema 7</b> -Aspekte etike-juridike të eutanazisë dhe sucidit.<br/><i>Përcaktimi i eutanazisë aktive dhe asaj pasive. Njohja me testamentin e jetës. Qëndrimet etike rreth sucidit.</i></p> <p><b>Tema 8</b>-Problemet etike-juridike të sëmundjeve neuro-psikike.<br/><i>Njohja me të drejtat e të sëmurit mendor. Etika speciale e infermierit në psikiatri.</i></p> <p><b>Seminar 4</b> Koncepti i eutanazisë dhe llojet e saj. Të drejtat e të sëmurit mendor.</p>  | <p><sup>(1)</sup>fq.36 -39</p> <p><sup>(1)</sup>fq. 40 -43</p> | <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> |
| V.   | <p><b>Tema 9</b>-Aspekte etike-juridike të vdekjes.<br/><i>Të dhena të përgjithshme mbi vdekjen. Kriteret e përcaktimit të vdekjes.</i></p> <p><b>Tema 10</b>-Pësoneli mjekësor, pacienti dhe sëmundja e tij në institucionet shëndetësore me shtretër (spitalet).<br/><i>Sjellje etike në Institucionet Shëndetësore me shtretër. Jatrojenitë dhe faktorët që luajnë rol në shfaqjen e tyre.</i></p> <p><b>Seminar 5</b> Njohja me kriteret përcaktimit të vdekjes dhe sjellja e personelit mjekësor në institucionet spitalore.</p>  | <p><sup>(1)</sup>fq.44 -52</p> <p><sup>(1)</sup>fq. 53 -59</p> | <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> |
| VI.  | <p><b>Tema 11</b>-Cilësia, akreditimi dhe performanca.</p>   | <p><sup>(1)</sup>fq.60 – 67</p>                                | <p>Leksion 1 orë</p>   |



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI VLORË”  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

| Java  | TEMAT E LËNDËS   | Literatura referuese   | Forma e mësimdhënies  |
|-------|--|--|---|
|       | <p><i>Menaxhimi i cilësisë në kujdesin shëndetësor, shtyllat e cilësisë në kujdesin shëndetësor dhe dimensionet e kësaj cilësie.</i><br/> <b>Tema 12-</b>Funksionet thelbësore të sigurimit dhe cilësisë.<br/> <i>Hapat për përmirësimin e cilësisë. Përlufizimi i akreditimit, qëllimi dhe struktura e organizimit të tij.</i></p> <p><b>Seminar 6</b> Cilësia në kujdesin shëndetësor dhe si ta përmirësojmë këtë cilësi përmes akreditimit.</p>   | ( <sup>1</sup> )fq.67 - 74                                     | Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë  |
| VII.  | <p><b>Tema 13-</b>Përformanca spitalore. Standartet në kujdesin parësor.<br/> <i>Njohja me indikatorët kryesorë të performancës spitalore. Klasifikimi i standardeve në kujdesin parësor në standarde minimale, optimale dhe ato të së ardhmes.</i><br/> <b>Tema 14-</b>Mjetet për matjen e performancës në kujdesin shëndetësor. Pjesa e parë.<br/> <i>Matja e performancës, si kthim në vlera sasiore e proceseve dhe rezultateve duke përdorur një ose më shumë dimensionet e performancës. Mjetet për mbledhjen e të dhënave.</i></p> <p><b>Seminar 7:</b> Të dimë si vlerësohet performanca në kujdesin shëndetësor.<br/> <b>Praktikë</b></p> | ( <sup>1</sup> )fq.74-78<br><br>( <sup>1</sup> )fq.79-83       | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë<br><br>Praktikë 5 orë |
| VIII. | <p><b>Tema 15-</b>Mjetet për matjen e performancës në kujdesin shëndetësor. Pjesa e dytë.<br/> <i>Udhëzimet për çdo fazë të matjes së performancës.</i><br/> <b>Tema 16-</b>Prezantim në menaxhimin e cilësisë.<br/> <i>Proceset e menaxhimit të cilësisë, veprimtaritë totale të duhura për determinimin dhe arritjen e cilësisë.</i></p> <p><b>Seminar 8:</b>Mjetet e nevojshme për matjen e performancës spitalore.</p>   | ( <sup>1</sup> )fq.83-87<br><br>( <sup>1</sup> )fq. 88-90      | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë                       |
| IX.   | <p><b>Tema 17-</b>Auditi i cilësisë.<br/> <i>Njohja me metodat e auditimit të cilësisë. Licensimi, certifikimi, akreditim, EFQM, vizitatë / inspektim.</i><br/> <b>Tema 18-</b>Menaxhimi i cilësisë në kujdesin infermieror.<br/> <i>Konceptet e cilësisë në kujdesin shëndetësor. Roli i profesionistëve dhe i institucioneve në cilësi.</i></p> <p><b>Seminar 9:</b>Si kryhet auditi i cilësisë dhe roli i menaxhimit në kujdesin infermieror.</p>   | ( <sup>1</sup> )fq.90-93<br><br>( <sup>1</sup> )fq.93-99       | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë                       |
| X.    | <p><b>Tema 19-</b>Udheheqje dhe bashkëpunim për përmirësim.<br/> <i>Mjedisi bashkëpunues dhe udheheqja me bashkëpunim.</i><br/> <b>Tema 20-</b> Udheheqje dhe bashkëpunim për përmirësim.<br/> <i>Rolet e ekipit.Struktura e drejtimit kompetent.Detyrat e drejtuesit.</i></p> <p><b>Seminar 10:</b>Rëndësia që ka bashkëpunimi në punë për të udhehequr rrugën drejt përmirësimit.</p>  | ( <sup>1</sup> )fq.100-101<br><br>( <sup>1</sup> )fq.101 - 103 | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë                       |
| XI.   | <p><b>Tema 21-</b>Cilësia dhe siguria.<br/> <i>Kultura e sigurisë në kujdesin shëndetësor.Indikatorët për cilësi dhe siguri.</i><br/> <b>Tema 22-</b> Cilësia dhe siguria.<br/> <i>Siguria e pacientit dhe rekomandimet mbi këtë çështje.</i></p>  | ( <sup>1</sup> )fq.104-106<br><br>( <sup>1</sup> )fq. 106-107  | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

| Java         | TEMAT E LËNDËS  | Literatura referuese  | Forma e mësimdhënies  |
|--------------|---|---|---|
|              | <b>Seminar 11:</b> Njohja me indikatorët për cilësi e siguri.   |   | Seminar 1 orë   |
| <b>XII.</b>  | <b>Tema 23</b> -Cilësia në kujdesin shëndetsor, monitorimi dhe indikatorët.<br><i>Roli i matjes së përformancës.Llojet e indikatorëve të matjes së cilësisë.</i><br><b>Tema 24-</b> Modelet e përmirësimit të jashtëm të cilësisë<br><i>Rëndësia e vlerësimit të jashtëm për profesionistët,për institucionet,për pacientët,për financierët dhe për qeverinë.</i><br><b>Seminar 12:</b> Vlera që ka matja e përformancës në kujdesin shëndetësor dhe indikatoët qe masin cilësinë.  | <sup>(1)</sup> <i>fq.108 - 111</i><br><br><sup>(1)</sup> <i>fq. 111-114</i> | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë                       |
| <b>XIII.</b> | <b>Tema 25-</b> Konceptet, indikatorët e Kujdesit Shëndetsor - shembuj.<br><i>Mekanizmat e sigurise dhe përmirësimit te cilesise ne KSh. Parandalimi i nfeksioneve kirurgjikale, i rezistencës medikamentoze etj.</i><br><b>Tema 26</b> -Kujdesi shëndetsor cilësor. Standartet e sigurisë.<br><i>Standarti si një masë kuantitative specifike,e magnitudës ose frekuencës. Standardet e ambientit të kujdesit dhe protokollet klinike.</i><br><b>Seminar 13:</b> Të njohim standardet aktuale që përdoren sot në ambientet e kujdesit shëndetësor. | <sup>(1)</sup> <i>fq.115-123</i><br><br><sup>(1)</sup> <i>fq. 124-129</i>   | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë                       |
| <b>XIV.</b>  | <b>Tema 27-</b> Pacienti në qendër të sistemit shëndetsor.<br><i>Modelet e kujdesit me pacientin në qendër.</i><br><b>Tema 38</b> -Të drejtat e pacientit dhe informimi.<br><i>Njohja me disa nga të drejtat e pacientit dhe e drejta për kujdesin me standard më të lartë.</i><br><b>Seminar 14:</b> Kujdesi me standardin më të lartë,një e drejtë themelore e cdo pacienti.<br><b>Prezantim projektsh</b>  | <sup>(1)</sup> <i>fq.129-131</i><br><br><sup>(1)</sup> <i>fq. 131-133</i>   | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë<br><br>Projekte 3 orë |
| <b>XV.</b>   | <b>Tema 29-</b> Mjetet bazë të cilësisë. Përdorimi në projekte të vogla.<br><i>Principet e përdorimit të mjeteve të menaxhimit të cilësisë.</i><br><b>Tema 30-</b> Mjetet bazë të cilësisë. Përdorimi në projekte të vogla.<br><i>Planifiko – Zbato – Vlerëso – dhe Ndrysho. Objektivat e projektit të vogël.</i><br><b>Seminar 15:</b> Të njihemi me mënyrën se si i përdorim mjetet bazë të cilësisë.<br><b>Prezantim projektsh</b>   | <sup>(1)</sup> <i>fq.133-135</i><br><br><sup>(1)</sup> <i>fq. 135-137</i>   | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Seminar 1 orë<br><br>Projekte 3 orë |

#### FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

|                     |  |
|---------------------|--|
| <b>FREKUENTIMI:</b> | Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e seminarit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me pedagogun. Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. |
|---------------------|--|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

|                            | <i>Forma e vlerësimit</i>  | <i>Koha e vlerësimit</i> | <i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>  | <i>Pikët maksimale</i> | <i>Forma e testimit të njohurive</i> | <i>Përmbajtja e testimit</i>        |
|----------------------------|--|--------------------------|---|------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>MËNYRA E VLERËSIMIT</b> | Provimi përfundimtar   | Fundi i semestrit        | Leksione 1-30   | 90 pikë                | Provimi me shkrim                    | pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz |
|                            | Detyra e kursit*   | Java 14/15               | Rastet klinike të trajtimit etik ose menaxhimi cilësor në institucione shëndetësore | 10 pikë                | Punim me shkrim                      | Studim rasti                        |
|                            | *Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të prezantojnë një studim rasti klinik nga pikepamja etike ose rast hipotetik të menaxhimit të cilësisë në institucionet shëndetësore, tematika e të cilit do të zgjidhet në përputhje me programin mësimor të këtij semestri. Punimi duhet të respektojë kriteret e kërkimit shkencor bazuar në llojin e studimit dhe metodologjinë e zgjedhur. Ai duhet të tregojë që në paraqitje një stil profesionist. Duhet të jetë i shtypur. Punimi duhet të ketë një volum me më tepër se 5 faqe (format A <sup>4</sup> , shkrimi Times Neë Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore. Ndalohen rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara. |                          |   |                        |                                      |                                     |
|                            | Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:  |                          |   |                        |                                      |                                     |
|                            | 40- 49 pikë  | 50-59 pikë               | 60-69 pikë  | 70-79 pikë             | 80-89 pikë                           | 90-100 pikë                         |
| 5                          | 6  | 7                        | 8   | 9                      | 10                                   |                                     |

### LITERATURA

|                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| <b>Literatura bazë e detyruar</b> | 1. Cikel leksionesh, përgatitur dhe përshtatur nga R.Lalo. FSHP-UV 2013<br>2. Strategjia e përmirësimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor' Tiranë 2006 . Dr Charles Shaë; Ms Helen Crisp ; Dr Isuf Kalo ; Dr Anthony Fenn ; Dr Andy Eats (Fakulteti i Mjekësisë - UT)   |
| <b>Literatura e rekomanduar</b>   | 'Etica profesionale për infermieri' ElleDici 2010<br>'Cilësia e shërbimeve spitalore në Shqipëri. Arritjet e projektit 2 vjeçar mbi treguesit e performancës dhe standartet e cilësisë për akreditim 2004- 2005'<br>'Standartet e cilësisë për akreditimin e institucioneve të KShP' - Shkurt 2009<br>'Etica nella ricerca biomedica' F.Angeli 2008 |

### VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

|                   |   |
|-------------------|---|
| <b>Dispozita:</b> | Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara. |
| <b>Vonesat</b>    | Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.   |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

|  |  |
|--|--|
| <b>Sjellja profesionale e studentit</b>            | Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik. |
| <b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b> | Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.   |